

**VENDIM**  
**Nr. 237, datë 27.3.2013**

**PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE  
KËSHILLIT KONSULTATIV TË BIZNESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 200 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr. 9607, datë 11.9.2006 “Për Këshillin Konsultativ të Biznesit” me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Këshilli Kombëtar i Punës dhe Këshilli Konsultativ i Biznesit bashkërendojnë punën për trajtimin e çështjeve që janë objekt i përbashkët i veprimtarisë së tyre.

2. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përgatisin mbledhje të përbashkëta të Këshillit Kombëtar të Punës dhe Këshillit Konsultativ të Biznesit, për çdo çështje që lidhet me politikat e zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe në mënyrë të veçantë për:

- a) procesin e përgatitjes së Buxhetit të Shtetit dhe të paketës fiskale;
- b) politikat kombëtare të zhvillimit ekonomik e shoqëror;
- c) politikat e zhvillimit të tregtisë dhe të biznesit;
- ç) politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit;
- d) politikat e privatizimit.

3. Mbledhjet e përbashkëta të Këshillit Kombëtar të Punës dhe të Këshillit Konsultativ të Biznesit bashkëdrejtohen nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës informojnë Kryeministrin për konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga mbledhjet e përbashkëta të Këshillit Kombëtar të Punës dhe Këshillit Konsultativ të Biznesit.

5. Bashkërendimi i veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Punës dhe të Këshillit Konsultativ të Biznesit, zhvillohet në vazhdimësi nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, përgatitjes së materialeve për mbledhjen e këshillave përkatës dhe për mbledhjet e përbashkëta, dhe gjatë veprimtarisë së komisioneve të specializuara të Këshillit Kombëtar të Punës.

Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerrin udhëzimet e nevojshme për mënyrën e bashkërendimit të veprimtarisë.

6. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**